



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201800963/10

Tiranë, \_\_. \_\_. 2018

**Lënda:** Rekomandohet marrja e masave për dhënien e pagave të prapambetura për shtetaset F. K., S. L., S. A., L. B. e R. Zh.

**Drejtuar:** B A SH K I S Ë  
Kryetarit, Z. Xhelal MZIU

**TIRANË**

I nderuar z. Mziu,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë shtetaset **F. K., S. L., S. A., L. B. e R. Zh.**, të cilat ankohet ndaj Bashkisë Kamzë, për mospagim të pagave të prapambetura, për punën e kryer.

Konkretisht, ato pretendojnë: **1. F. K.**, në datë 04.12.2017, është komanduar edukatore në Kopshtin "Kamza e Re", me afat një vit kalendarik; **2. S. L.**, në datë 01.11.2017, është emëruar sekretare në Gjimnazin "Isa Boletini"; **3. S. A.**, në datë 10.10.2017, është emëruar mësuese në arsimin parashkollor, pranë Shkollës 9-vjeçare "Niko Hoxha", Valias; **4. L. B.**, në datë 11.09.2017, është emëruar edukatore në kopshtin "Lidhja e Prizrenit" në Paskuqan; **5. R. Zh.**, në datë 01.11.2017, është emëruar edukatore (arsim-parashkollor) në shkollën 9-vjeçare "Tahir Sinani", Paskuqan, por të gjitha, nga fillimi i punës dhe deri sot, nuk janë paguar për punën e kryer.

Referuar kërkesës për informacion të Institucionit të Avokatit të Popullit, me tuajën nr. 4184/1 Prot., datë 31.07.2018, informoni: "**... Me zbatimin e reformës administrative-territoriale, një sërë kompetencash do të ... delegoheshin në menaxhim dhe administrim të pushtetit lokal ... Këto kompetenca u deleguan në të gjitha bashkitë e vendit me përjashtim të Bashkisë Kamzë ...**".

Sa sipër, iu drejtuaam Zyrës Arsimore Kamzë, e cila me shkresën nr. 901 Prot., datë 10.09.2018, sqaron ndër të tjera: "**... Punonjësit e arsimit parashkollor dhe personeli jo-mësimor (Sekretaret e shkollave), u është kaluar fondi i pagave për financim në njësitë e qeverisjes vendore (Bashki), ndaj përgjegjëse për mospagesën e edukatorëve në kopshtet në territorin e bashkisë Kamzë, është Bashkia Kamzë.**"

Në zbatim të Urdhrit nr. 127, datë 16.09.2015, të Kryeministrit "Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale, për decentralizimin dhe qeverisjen vendore", Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka realizuar transferimin e fondeve në njësitë e qeverisjes vendore që nga data 01.12.2015 e në vazhdim. **Punonjësit e arsimit parashkollor dhe personeli jo-mësimor (sekretaret e shkollave) u është kaluar fondi i pagave për financim në njësitë e qeverisjes vendore**

*(Bashki), ndaj përgjegjëse për mos pagesën e znj. F. K., edukatore në kopshtin “Kamza e Re”; S. L., sekretare në Gjimnazin “Isa Boletini”; S. A., mësuese në arsimin parashkollor, pranë Shkollës 9-vjeçare “Niko Hoxha”; L. B., edukatore në kopshtin “Lidhja e Prizrenit” në Paskuqan, si dhe R. Zh., edukatore (arsim-parashkollor) në shkollën 9-vjeçare “Tahir Sinani”, është Bashkia Kamzë”.*

Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, në respektim të të gjithë legjislacionit në fuqi, është e nevojshme, që nga ana juaj, të përfshihet në parashikimin e projekt-buxhetit të vitit 2019, të Bashkisë Kamzë, fondi për pagimin e pagave të prapambetura për punonjëset e mësipërme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga qëllimi i mirë për mirëfunksionimin dhe përmirësimin e punës për çdo organ të Administratës Vendore, çmon me vend të bëjë këtë rekomandim për të kontribuar së bashku në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por edhe për t’ju përgjigjur standardeve të një vendi që ka në qendër të vet mirëqenien e qytetarëve.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

### **REKOMANDOJMË:**

***- Marrjen e masave për përfshirjen në buxhetin e vitit 2019 të Bashkisë Kamzë, të fondit për pagimin e pagave të prapambetura, për punën e kryer, të punonjëseve, znj. F. K., S. L., S. A., L. B. e R. Zh..***

Në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lutemi të na ktheni përgjigje të argumentuar brenda 30 ditëve, lidhur me qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**